



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:232223

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05627482

C.nr. 429/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.A , A.A , Sh.A dhe E.A , me përfaqësuesin ligjore Sh.A , dhe E.A me përfaqësues ligjor F.A , të gjithë nga Vushtrria, të cilët i përfaqëson A.L avokat në Prishtinë, lagjja .. rruga .., kundër të paditurës B.. me adresë .., të cilën e përfaqëson Kompania e Sigurimeve “...” nga Prishtina rruga “.., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seance me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.429/18 e datës 25.09.2018, e paditësve F.A , A.A , Sh.A dhe E.A , me përfaqësuesin ligjore Sh.A , dhe E.A me përfaqësues ligjor F.A , të gjithë nga Vushtrria, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me adresë magjistrerja Prishtinë-Fushë Kosovë, lidhur me çështjen kontestimore-kompensim dëmi.

II. REVOKOHET aktvendimi i datës 18.04.2024, për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e Ortopedisë dhe Psikiatrisë.

A r s y e t i m

Paditësit F.A ,A.A , Sh.A dhe E.A , me përfaqësuesin ligjore Sh.A , dhe E.A me përfaqësues ligjor F.A , të gjithë nga Vushtrria, përmes të autorizuarit të tij, me datë 25.09.2018, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës B.. me seli në Prishtinë, rruga “...

Gjykata me datë 18.04.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën përfaqësuesi i paditësve ka mbetur pranë padisë dhe ka propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e

Ortopedisë dhe Psikiatrisë, për të përcaktuar natyrën, shkallën edhe frikën e paditësve, të shkaktuara më aksidentin e komunikacionit me datë 15.10.2017.

I autorizuari i të paditurës nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësve e as nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e Ortopedisë dhe Psikiatrisë. Gjykata ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të paditësve dhe ka vendosur marrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë.

I autorizuari i paditëses me parashtresën e dërguar në mënyrë elektronike me datë 26.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore, një kopje të së cilës ja ka bashkëngjitur parashtresës dhe se e tërheq padinë.

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.429/18, me datë 26.04.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.